URDHËR
Nr. 336, datë 22.12.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" dhe nenit 14, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Ronelda Rrapollari.
2. Delegimin e kompetencave për njoftimin dhe ndjekjen e realizimit të detyrimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, Sekretarit të Përgjithshëm të AMA-s.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 22.12.2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Armela Krasniqi